



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/71


Datë: 22.01.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 22 Janar 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkriptet nga mbledhjet 63, 64 dhe 65 të Qeverisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/71

Datë: 22.01.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 22 Janar 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Strategjia Kombëtare për Zhvillim (SKZH) 2016-2021.
2. Aranzhimet e zbatimit do të bëhen përmes udhërrëfyesve për zbatimin e SKZH-së:
 - 2.1. Ministrinë përgjegjëse për arritjen e objektivave të SKZH-së obligohen që brenda tre muajve të përgatisin Udhërrëfyesit për zbatimin e saj, që mbulojnë periudhën e ardhshme tri vjeçare;
 - 2.2. Zyra për Planifikim Strategjik e Zyrës së Kryeministrit përgatit udhëzimet përkatëse për përgatitjen e Udhërrëfyesve për zbatimin e SKZH-së.
3. Qeveria integron kornizën e vet të planifikimit strategjik për të siguruar burimet financiare të kërkuara për zbatim të udhërrëfyesit.
4. Ministria e Financave siguron se veprimet e SKZH-së gëzojnë qasje preferenciale në kuadër të planifikimit të buxhetit vjetor dhe Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve.
5. Ministria e Integritimit Evropian siguron që masat dhe veprimet përkatëse të SKZH-së janë të përfshira në dialogun me partnerët zhvillimor për programimin e çdo ndihme shtesë për zhvillim.
6. Ministria e Integritimit Evropian siguron se dokumentet planifikuese të sektorit dhe dokumentet tjera të kërkuara për programim të IPA-së II dhe fondeve tjera të BE-së janë përpiluar na bazë të prioriteteve të larta të Qeverisë.
7. Monitorimi i zbatimit të SKZH-së do të bëhet në kuadër të Planit Vjetor të Punës së Qeverisë:
 - 7.1. Zyra për Planifikim Strategjik dhe Sekretariati Koordinues i Qeverisë janë përgjegjëse për monitorimin e progresit të zbatimit dhe sigurojnë raporte periodike për Qeverinë;

- 7.2. Zyra për Planifikim Strategjik organizon rishikimet e rregullta të progresit për Kryeministrin dhe mbështet Kryeministrin në identifikimin e vështirësive që duhet të eliminohen përmes intervenimit politik, koordinimit më të mirë dhe masave financiare, menaxheriale apo personelit;
 - 7.3. Për qëllime të monitorimit të SKZH-së, Qeveria shqyrton progresin e zbatimit të prioritetëve përmes mekanizmave ekzistues të bashkëpunimit me sektorin privat dhe shoqërinë civile;
 - 7.4. Zyra për Planifikim Strategjik në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe me mbështetjen e Ministrisë së Integritimit Evropian siguron që progresi i zbatimit të SKZH-së reflektohet në Programin e Reformave Ekonomike, si mjet kryesor për dialogun me Bashkimin Evropian për qeverisje ekonomike.
8. SKZH vlerësohet plotësisht në intervale dy vjetore dhe vlerësimin përfundimtar në vitin e fundit të zbatimit të saj. Aranzhimet e vlerësimit të SKZH-së do të bëhen si në vijim:
- 8.1. Zyra për Planifikim Strategjik do të paraqes në Qeveri një metodologji gjithëpërfshirëse dhe të përshtatshme të vlerësimit, zbatimi i së cilës mund t'i besohet rrjeteve të organizatave të shoqërisë civile në Kosovë;
 - 8.2. Qeveria, mundë të kërkoj apo të merr parasysh vlerësimet e pavarura të zbatimit të SKZH-së nga ana e organizatave ndërkombëtare;
 - 8.3. Shqyrtimi i raporteve të vlerësimit do të koordinohet përmes Grupit Drejtues për Planifikim Strategjik, dhe i prezantohet Komisionit për Planifikim Strategjik për Shqyrtim përfundimtar;
 - 8.4. Komisioni për Planifikim Strategjik në emër të Qeverisë publikon raportet e vlerësimit, fton publikun për komente dhe i përgjigjet përmes ndryshimeve në zbatim dhe prioritetet të SKZH-së sipas nevojës.
9. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Zyra e Kryeministrit, Ministria e Financave, Ministria e Integritimit Evropian dhe institucionet përgjegjëse.
10. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/71

Datë: 22.01.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 22 Janar 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Strategjia Shtetërore për Sigurinë Kibernetike dhe Plani i Veprimit për vitet 2016-2019.
2. Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme caktohet Koordinator Nacional për Sigurinë Kibernetike, i cili këtë përgjegjësi mund ta delegoj te njëri nga zëvendësministrat e Ministrisë së Punëve të Brendshme.
3. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme që aktivitete të caktuara të Planit të Veprimit nga pika 1. e këtij vendimi t'i kategorizojë si informacione të klasifikuara në pajtim me legjislacionin për klasifikimin e informacionit dhe verifikimin e sigurisë.
4. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe Institucionet tjera kompetente për zbatimin Strategjisë nga pika 1. e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/71

Datë: 22.01.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 22 Janar 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes financiare për IPA 2015 për bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian.
2. Obligohet Ministria e Integritimit Evropian që të ndërmarrë të gjitha hapat në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim të finalizimit të tekstit përfundimtar të marrëveshjes.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/71

Datë: 22.01.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, nenit 7. paragrafi 1. nënparagrafi 1.57, nenit 14 dhe nenit 19 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës, Ligjit Nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore dhe nenit 18 paragrafi 5. të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 22 Janar 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Shpallet **Zonë e Veçantë e Mbrojtur** hapësira në sipërfaqe prej 4.280 ha, e emërtuar si **"Zona e Gadimës"** e cila shtrihet në teritorin e Komunës së Lipjanit.
2. Kufijtë e hapësirës së zonës së veçantë të mbrojtur nga pika 1. e këtij vendimi janë të përshkruar në situacionin grafik si pjesë e studimit të kësaj zone, e cila paraqet pjesën përbërëse të këtij vendimi.
3. Hapësira e shpallur si zonë e veçantë e mbrojtur sipas këtij vendimi do të inkorporohet në Hartën Zonale të Kosovës si zonë e veçantë me veçori specifike, të cilat kërkojnë regjim të posaçëm organizativ të përdorimit dhe mbrojtjes përmes Planit Hapësinor për Zona të Veçanta, me të cilin plan do të përcaktohen saktësisht kufijtë e kësaj zone të mbrojtur.
4. Ditën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi do të ndërpriten të gjitha aktivitetet dhe zhvillimet tjera të cilat ndikojnë në aspektin e cenimit të veçorive specifike të cilat kanë ndikuar në shpalljen e kësaj hapësire si zonë e veçantë nën mbrojtje.
5. Obligohen Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komuna e Lipjanit për zbatimin e këtij vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- K. K. Lipjan
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/71

Datë: 22.01.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 22 Janar 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Programi për zbatimin e Strategjisë Minerare të Republikës së Kosovës për periudhën 2015-2017.
2. Obligohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Institucionet tjera kompetente për zbatimin Programit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/71


Datë: 22.01.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 22 Janar 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-237 dhe me Ligjin Nr. 05/L-068.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë